



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Numëri i Dokumentit / Dokument No. / No. of Document	15.03.2022	2	viti / vitet / year
Organ / Organizata / Org. / Org. / Org.	1390	2022	118



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.128/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.128/2022 të datës 14.02.2022, të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat me adresë rruga në Prishtinë dhe Avokat me adresë në Prishtinë, kundër Vendimit me Nr.0027/2022 të datës 24.01.2022 të Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, në çështjen juridike "largim nga shërbimi civil", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 15.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.128/2022 e datës 14.02.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr.0027/2022 i datës 24.01.2022 i Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë.

A r s y e t i m

Ministrja e Ministrisë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë më datë 18.11.2021 ka paraqitur kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit tek Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë më arsyetim për mungesë të paarsyeshëm në punës për më shumë se pesë (5) ditë dhe mos përmbushje e detyrave të punës.

Në bazë të dëshmimeve kërkesa për inicim të procedurës disiplinore më datë 24.11.2021 është pranuar nga kabineti i Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme i cili është edhe Kryesues i Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë.

Më datë 21.12.2021 Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë ka nxjerr Vendim me Nr. 0808 me të cilin ka bërë shtyrjen e afatit në procedurë administrative për shkak të kompleksitetit të lëndës. Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë më datë 21.12.2021 ka nxjerr Vendim me Nr. 0809 me të cikin ka bërë pezullimin nga detyra të ankuesit.

Pas shqyrtimit të rastit të ankuesit dhe vlerësimit të kërkesës për inicimin e procedurës disiplinore, Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë më datë 24.01.2022 ka nxjerr Vendim me Nr. 0027/2022 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "largimi nga shërbimi civil".

Ankuesi, i pakënaqur me Vendimit me Nr.0027/2022 të datës 24.01.2022 të Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes përfaqësuesve të tij fizikisht më datë 14.02.2022 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot:716/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 21.02.2022 ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë. Më datë 25.02.2022 kemi pranuar përgjigje në ankesë nga Sekretariati i Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.Prot:716/2022 të datës 14.02.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 17.01.2022 dhe 18.01.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 21.02.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 25.02.2022; Vendimin me Nr.0027/2022 të datës 24.01.2022 të Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë; Vendimin me Nr.0808 të datës 21.12.2021 të Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë; Vendimin me Nr.0809 të datës 21.12.2021 të Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë; Vendimin me Nr.08/59 i datës 21.01.2021 i Qeverisë së Kosovës; Procesverbalin e seancës së disiplinore të Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë i datës 18.01.2022; Deklaratë nga Sekretaria e Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë; Emailin e datës 22.12.2021 nga Njoftimin për fillimin e procedurës disiplinore e datës 14.12.2021 nga Emaili i datës 03.01.2022 nga ankuesi për Emailin e datës 12.01.2022 nga për ankuesin; Vendimin me Nr. 0009 i datës 14.01.2022 nga

Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë për lejimin e qasjes në emailin zyrtar; Emailin e datës 12.01.2022 nga ankuesi për [redacted] Emailin e datës 23.12.2021 nga ankuesi për [redacted] Emailin e datës 19.01.202 nga [redacted] për [redacted] Emailin e datës 19.01.2022 nga [redacted] për A.Krasniqi; Emailin e datës 19.01.2022 nga [redacted] për [redacted] Kërkesën për fillim të procedurës disiplinore e datës 18.11.2021; Raport javor nga [redacted] datës 27.08.2021; Raport Javor nga [redacted] datë 22.09.2021; Emailin e datës 11.06.2021 nga [redacted] për [redacted] Raporti i prezencës në punës për periudhën 01.03.2021-11.06.2021, 21.07.2021-29.09.2021; Vendimin e datës 21.07.2021 të Ministrisë së MINT; Emailin e datë 14.09.2021, 29.09.2021 nga [redacted] Raporti i prezencës në punës për periudhën 22.03.2021-29.09.2021; Vendimin e datës 28.07.2021 nga Ministria e MINT; Raporti i prezencës në punës për periudhën 28.07.2021-29.09.2021; Vendimin e datës 19.05.2021 nga Ministria e MINT; Raporti i prezencës në punës për periudhën 19.05.2021-29.09.2021; Emailin e datës 11.08.2021 nga ankuesi për [redacted] Emailin e datës 06.08.2021 nga [redacted] për ankuesin; Projekt Rregulloren Nr. XX/2021 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Agjencisë së Standardizimeve të Kosovës; Raporti i realizimit të planit të punës AKS 2020; Raporti i realizimit të planit të punës AKS 2021; Parashtrësë lidhur me pretendimet e ngritura në shkresë e datës 18.11.2021 evidentuar me numër protokollit 9432-01 të datës 18.01.2022 nga ankuesi; Raportimin i Nën komisionit MSA përmes emailit nga ankuesi më datë 21.05.2021; Emailin e datës 02.04.2021 nga ankuesi; Emailin e datës 02.04.2021 nga [redacted] për ankuesin; Rregullore e Brendshëm Nr. 03/2021 për Notifikimin e Standardeve në CEN/CENELEC; Emailin e datës 07.04.2021 nga ankuesi; Raporti 100 ditor i punës periudha mars 2021-qershor 2021; Emailin e datës 10.06.2021 nga ankuesi për [redacted] dhe [redacted] Vendimin e datës 06.08.2021 nga ankuesi; Emailin e datës 07.07.2021 nga [redacted] Emailin e datës 01.06.2021 nga ankuesi për [redacted] Emailin e datës 29.04.2021 nga ankuesi për [redacted] Emailin e datës 28.04.2021 nga [redacted] Emailin e datës 28.04.2021 nga [redacted] Emailin e datës 27.04.2021 nga ankuesi për [redacted] dhe [redacted] Emailin e datës 20.04.2021 nga ankuesi për [redacted] dhe [redacted] Emailin e datës 20.04.2021 nga D.Selmani; Emailin e datës 25.03.2021 nga ankuesi për [redacted] Emailin e datës 25.03.2021 nga [redacted] për ankuesin; Emailin e datës 25.03.2021, 24.03.2021, 16.03.2021, 04.03.2021, 18.10.2021 nga ankuesi; Emailin e datës 22.10.2021 nga [redacted] Emailin e datës 11.08.201 nga ankuesi për [redacted] Emailin e datës 11.08.2021 nga [redacted] Emailin e datës 16.12.2021 nga ankuesi për [redacted] Emailin e datës 26.08.2021 nga [redacted] Raportin Javor të punës 10.12.2021-17.12.2021; Emailin e datës 28.07.2021 nga [redacted] për [redacted] Emailin e datës 27.07.2021 nga [redacted] për [redacted] Emailin e datës 27.07.2021 nga [redacted] për ankuesin; Emailin e datës 27.07.2021 nga ankuesi për [redacted] Vendim i datës 05.08.2021; Raporti javor 03.12.2021-10.12.2021; Raporti javor 26.11.2021-03.12.2021; Emailin e datës 14.07.2021 nga [redacted] Emailin e datës 27.05.2021 nga ankuesi për [redacted] Emailin e datës 02.08.2021 nga [redacted] për [redacted] Vendimin e datës 02.10.202 nga Zv. Sekretare e Përgjithshëm e MTI; Emailin e datës 15.06.2021 nga ankuesi për [redacted] Emailin e datës 14.06.2021 nga [redacted] Raporti javor 10.12.2021-17.12.2021; Emailin e datës 09.07.2021 nga ankuesi për [redacted]

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, konstaton se ankesa e ankuesit, është e pabazuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës, ankuesi në bazë të Vendimit me Nr.08/59 të datës 21.01.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës është transferuar në pozitën Kryeshef Ekzekutiv në Agjencinë Kosovare të Standardizimit në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Ankuesi në ankesën e tij të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.0027/2022 të datës 24.01.2022 të Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, pretendon që lënda është parashkruar sepse këshilli nxjerr vendim në afat prej 30 ditësh nga dita kur e pranon kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore nga burimet njerëzore; po ashtu pretendon që Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë ka bërë shkelje të dispozitave të legjislacionit të në fuqi me rastin e shqiptimit të masës disiplinore sepse dispozitivi i këtij vendimi është i paqartë për faktin që nuk janë vlerësuar në mënyrë të drejtë faktet juridike.

Lidhur me kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit e paraqitur nga Ministria e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë të datës 18.11.2021, e parashtruar pranë Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, e njëjta është bërë për arsyet që ankuesi ka braktisur vendin e punës ose mungesë e paarsyeshme dhe e vijueshmërisë për pesë (5) ditë punë apo më shumë dhe për shkelje të detyrave të punës, duke konstatuar se me këto veprime ka bërë shkelje të nenit 46 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson kërkesa për inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit më datë 24.11.2021 është pranuar në kabinetin e Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ku Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme është edhe Kryesues i Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, rrjedhimisht afati për vendosje Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë i ka rrjedhë nga data 24.11.2021.

Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, konkretisht neni 135 paragrafi 1, përcaktojnë që: *"Përpos kur ligji parashih një afat të ndryshëm, akti administrativ që zgjidh ankesën do të nxirret dhe njoftohet palës brenda tridhjetë (30) ditëve nga parashtrimi i ankesës"*, në rastin konkret procedurat disiplinore për pozitat e Kategorisë së Nëpunësve Civil të Nivelit të Lartë Drejtues sipas nenit 25 të Rregullores Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, përcaktohet se: *"Procedura disiplinore fillon, zhvillohet dhe përfundohet në pajtim me dispozitat e Rregullores përkatëse për disiplinën e zyrtarëve publik"*, ndërlidhur me këtë neni 12 paragrafi 6 i Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, i cili përcakton se: *"Komisioni disiplinor duhet të marrë vendim brenda 30 ditëve pas pranimit të kërkesës për inicim të procedurës nga njësia për burime njerëzore"*, mirëpo ky afat mund të shtyhet për shkak të kompleksitetit të lëndës, siç parashihet me nenin 135 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Afati i paraparë nga paragrafi 1 i këtij neni, mund të shtyhet kur nevojiten shqyrtime administrative shtesë. Neni 99 i këtij Ligji do të zbatohet përshtatshëm"*

gjithashtu për shtyrjen e afatit të paraparë sipas paragrafit 1 të këtij neni”, kështu që në bazë të provave të lëndës Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë Vendimin me Nr. 0808 të datës 21.12.2021 me të cilin ka bërë shtyrjen e afatit në procedurë administrative për shkak të kompleksitetit të lëndës, e ka nxjerr në pajtim me nenin 99 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: “1. Përveç kur ndalohet shprehimisht me ligji, nëse është e nevojshme për shkak të kompleksitetit të çështjes administrative konkrete, organi publik mund të shtyjë, vetëm një herë, afatin fillestar të paraparë për përfundimin e procedurës administrative, sipas nenit 98 të këtij Ligji. 2. Shtyrja sipas paragrafit 1 të këtij neni, do të bëhet për aq kohë sa është e nevojshme për të përfunduar procedurën administrative dhe duhet të jetë në përpjesëtim me kompleksitetin e çështjes konkrete, por nuk mund të jetë më e gjatë se afati fillestar”, andaj pretendimi ankimor i ankuesit se lënda është parashkruar sepse këshilli nxjerr vendim në afat prej 30 ditësh nga dita kur e pranon kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore nga burimet njerëzore, është i pabazuar dhe i pa argumentuar.

Lidhur me pretendimet e iniciuesit të procedurës disiplinore dhe po ashtu lidhur me rrjedhshmërinë e shqyrtimit të lëndës disiplinore ndaj ankuesit lidhur me mungesën në punë për më shumë se pesë (5) ditë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar që pozita e ankuesit Kryeshf Ekzekutiv në Agjencinë Kosovare të Standardizimit, sipas Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht nenit 2 paragrafi nën paragrafi 2.1, përcaktohet që: “Zyrtarë publikë janë: 2.1. nëpunësi i Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil)”, ndërlidhur me këtë paragrafi 3 i këtij neni përcakton se: “Nëpunës civil - është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë”, në këtë kuptim regjistrimi në librin e vijueshmërisë në punë është obligim për të gjithë zyrtarët publikë, siç parashihet me dispozitat e nenit 8 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, i cili përcakton se: “Gjatë orarit të punës të gjithë zyrtarët publik janë të obliguar të jenë në vendin e punës. Çdo zyrtar publik shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik”.

Në bazë të provave të lëndës, ankuesi nuk ka arritur të dëshmoj se për gjatë periudhës mars-nëntor 2021 (përfshijtur kohën sa ka qenë duke u trajtuar për shkak të COVID-19) është evidentuar në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik, ndërsa në bazë të provave të lëndës nuk ka asnjë dëshmi që ankuesi është evidentuar në librin e vijueshmërisë në punë, ndërsa sipas emailit të datës 11.06.2021 të znj. të gjithë Kryeshfat Ekzekutiv të Agjencive në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë janë të pajisur me ID kartelat e vijueshmërisë në punë. Lidhur me mos vijueshmërinë në punë respektivisht mos evidentimin në këtë sistem, gjatë seancës disiplinore të Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë të datës 18.01.2022, gjatë pyetjes

së kryesuesit të Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë se: *"a jeni regjistruar kur keni hyrë dhe kur keni dal nga puna?"*, ankuesi është përgjigjur *"Jo rregullisht, jo"*.

Bazuar në provat e lëndës të ofruara nga palët në procedurë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankuesi më veprimet e tij për mos regjistrim në librin e vijueshmërisë në punë, nuk ka mund të dëshmoj që për atë kohë ka qenë prezent gjithë kohën në vendin e tij të punës, ndërsa mos respektimi i orarit të punës paraqet shkelje disiplinore siç parashihet me nenin 8 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, duke bërë shkelje disiplinore të natyrës së rëndës që parashihet me nenin 46 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1, paragrafi 3 paragrafi 3.5 dhe 3.10 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Lidhur me pretendimet e iniciuesit të procedurës disiplinore për mos përmbushje e detyrave të punës nga ana e ankuesit, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të të gjitha provave të lëndës, konstaton se gjatë diskutimeve në seancës disiplinore të Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë të datës 18.01.2022, ankuesit i është kërkuar që të procedoj draftin e Rregullores për Nostrifikimin e Standardeve në kuadër të Agjencisë Kosovare të Standardizimit, ku iniciuesja e procedurës disiplinore më datë 06.08.2021 përmes emailit i ka kërkuar ankuesit të t'ia përcjell këtë rregulloren mirëpo ankuesi përmes emailit të datës 11.08.2021 i ka dërguar znj. *Projekt Rregulloren për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Agjencisë së Standardizimeve të Kosovës. Po ashtu ankuesi nuk ka ndër marr veprimet konkrete për propozimin e anëtarëve të Këshillit Profesional të Standardizimit siç parashihet me dispozitat e nenit 9 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L-019 për Standardizim, i cili përcakton se: "Anëtarët e KPS-së propozohen nga AKS dhe emërohen me vendim të Ministrit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë"*.

Sa i përket performancës së Agjencisë Kosovare të Standardizimit, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, i'u është referuar Raportit të realizimit të planit të Punës AKS 2020 dhe Raportit të realizimit të planit të Punës AKS 2021, ku në vitin 2020 kishte 42 Komitete Teknike ndërsa në vitin 2021 kishte 19 Komitete Teknike, ndërsa në vitin 2020 kishte adaptim të 516 standardeve kurse në vitin 2021 kishte adaptimin e 243 standardeve, në këtë rast gjatë kohës nën menaxhimin e ankuesit Agjencia Kosovare të Standardizimit ka pasur performancës më të ulët në krahasim me një vit paraprak, me këtë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankuesi nuk ka përmbushur në tersi detyrat e tij të përcaktuar me nenin 8, 9 dhe 10 të Ligjit Nr. 06/L-019 për Standardizim, kështu që ka bërë shkelje të nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Në bazë të provave të lëndës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankuesi në cilësinë e Kryeshef Ekzekutiv në Agjencinë Kosovare të Standardizimit, gjatë vitit 2021 ka dërguar vetëm dy raporte javore: Raportin Javor të punës së Agjencisë Kosovare të Standardizimit Nr.46 për periudhën 03.12.2021-10.12.2021 dhe Raportin Javor të punës së Agjencisë Kosovare të Standardizimit Nr.47 për periudhën 10.12.2021-17.12.2021, ndërsa sipas kësaj këto dy raporte janë të dërguara vetëm pasi që është bërë kërkesa për

inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit, mirëpo ankuesi nuk ka dëshmuar me asnjë provë të vetme që këto raporte por edhe raporte të tjera javore për vitin 2021 t'i ketë dërguar të mbikëqyrësi i tij i drejtpërdrejt, me këtë rast ankuesi me këto veprime i është shmangur detyrimit për të raportuar për punën e tij dhe të institucionit që menaxhon, si rrjedhojë nuk është vepruar konform nenit 23 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura.

Bazuar në të lartcekurat, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit, me rastin e parashtrimit të kërkesës për inicimin e procedurës disiplinore, ka vepruar në pajtim me nenin 48 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil"*, ndërsa Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë me rasatin e nxjerrës së Vendimit me Nr.0027/2022 të datës 24.01.2022, në mënyrë të drejtë ka konstatuar shkeljen e bërë nga ankuesi, në këtë rast ka vepruar në pajtim me nenin 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sepse ka konstatuar saktë elementet e përgjegjësisë disiplinore si: *ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit; kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; ndodhja e pasojës; ndodhja e dëmit dhe lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit, po ashtu masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankuesit, është në përputhje të plotë me dispozitat ligjore në fuqi, respektivisht nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4, nenin 48 paragrafi 3, nenin 50 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 11, nenin 12, nenin 13 paragrafi 3, paragrafi 4 nën paragrafët 4.1 dhe 4.2 dhe paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, në këtë rast Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë Vendimin me Nr.0027/2022 të datës 24.01.2022 përveç kësaj e ka nxjerr duke u bazuar në provat vendimtare që kanë të bëjnë më rastin konkret, dhe të njëjtin e ka arsyetuar në përputhje të plotë me nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimet e ankuesit i cili pretendon se Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë ka bërë shkeleje të dispozitave të legjislationit të në fuqi me rastin e shqiptimit të masës disiplinore sepse dispozitivi i këtij vendimi është i paqartë për faktin që nuk janë vlerësuar në mënyrë të drejtë faktet juridike, janë pretendimet të pa bazuar dhe pa argumentuara.*

Duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej

tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.128/2022, datë 15.03.2022

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- *Përfaqësuesit të ankuesit Avokat [redacted] dhe Avokat [redacted]*
- *Ministres së Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;*
- *Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme;*
- *Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme;*
- *Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK- së;*

